



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**

**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**PA1 Nr.03-12**

**10.01. 2023**

**Shkup**

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), alinea 20 dhe nenin 23, paragrafi (1), alinea 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21) dhe neni 51, paragrafi (1) nga i njëjti Ligj, dhe në lidhje me nenin 2, paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.96/19), neni 3 i Kodit Penal („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.37/96, 80/99, 48/01, 4/02, 16/02, 43/03, 19/04, 40/04, 81/05, 50/06, 60/06, 73/06, 87/07, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 143/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 41/14, 41/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17, 170/17, 248/18), pika 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimit të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) me nr.ark.01-6039/1 datë 20.10.2015, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me nr.ark.10-4621/1 datë 15.12.2022, dhe Konkluzionin me nr.ark.02-39/9 datë 10.1.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 1-rë mbajtur më 9.1.2023, në pajtueshmëri, miratoi si në vijim:

**Aktvendim  
për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMROHET Institucioni radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë, për shkeljen e kryer të nenit 51, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), në mënyrë që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor në radio të transmetuar më 2 dhjetor 2022 nuk ka ofruar informacionin që duhet t’u vihet në dispozicion përdoruesve (shfrytëzuesve).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me nr.ark.10-4621/1 datë 15.12.2022, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET Institucioni radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë, që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e vërtetimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave në aspektin e pajtueshmërisë së punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për mediat, LSHMAAV dhe rregulloret e miratuara bazuar në Ligj.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) alinea 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe të akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligji të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akteve të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale duhet përdoruesve të tyre t'u ofrojnë qasje (akses) të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershëm për të dhënat në vijim: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio dhe audiovizual, emërtimin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e shkurtuar të identifikimit (avizo, logo dhe të ngjajshme); adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio dhe audiovizual; të dhënat për kontakt me ofruesin e shërbimit mediatik audio dhe audiovizual (numër telefoni, adresën e postës elektronike e-mail ose/të uebfaqes, personin për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundur dhe për organin rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave të veta Ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 15 dhjetor 2022, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor në radio të Institucionit radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë, transmetuar më 2 dhjetor 2022, në nivel lokal, nga ku konstatoi shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Me mbikëqyrjen e rregullt administrative është konstatuar se më 2 dhjetor 2022, shërbimi programor në radio i Institucionit radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë, nuk ka ofruar informacionin që duhet të vihet në dispozicion të përdoruesve, dmth. nuk u mundësoi përdoruesve të tij akses(qasje) të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershëm të paktën për të dhënat në vijim: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audio audiovizual; adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio; të dhënat për kontakt (numër telefoni, adresën e postës elektronike e-mail ose/ uebfaqes; personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 i këtij Aktvendimi, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative me nr.ark.10-4621/1 datë 15.12.2022, e cila është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë pranë institucionit radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë më 19.12.2022, ka dërguar Shkresë me nr.ark.10-4621/2 datë 19.12.2022, me të cilën i ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me nr.ark.10-4621/1 datë 15.12.2022, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV.

Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më datë 21.12.2022, për të cilën në afatin e paraparë, institucioni radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV, Nr.yne.ark.03-4882/1 datë 27.12.2022, Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 9.1.2023, e shqyrtoi Raportin me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim dhe konstatoi se institucionit radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, bazuar në nenin 18 paragrafi (1) alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi (1) alinea 1 të LSHMAAV dhe neni 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, dhe në lidhje me nenin 2 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtje, neni 3 të Kodit Penal, pika 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) me nr.ark.01-6039/1 datë 20.10.2015, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me nr.ark.10-4621/1 datë 15.12.2022 dhe Konkluzionin me nr.ark.02-39/9 datë 10.1.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 9.1.2023, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron institucionin radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë dhe urdhëron që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij radiodifuzeri ka të drejtë për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër është marrë aktvendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me nr.ark.10-4621/1 datë 15.12.2022.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale,  
Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.

**Dorëzuar deri tek:**

- Institucionit radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë;
- Personit të autorizuar të institucionit radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë;
- Personit përgjegjës të programit në Institucionin radiodifuziv jofitimprurës RADIO MARIJA – BLAGOVEST Strumicë;
- Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike;
- Sektorit për çështje programore; dhe
- Personave të emëruar në Agjencion për udhëheqjen e Regjistrit PA1.